




Buxheti

Auditimet e pavarura dhe të vazhdueshme të pasqyrave financiare me cilësi të lartë janë thelbësore për të ndihmuar në sigurimin e raportimit financiar të besueshëm dhe të përshtatshëm për ekonominë e vendit tonë. Aktiviteti mbikëqyrës i realizuar nga BMP është thelbësor për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së auditimit për mbrojtjen e interesit të publikut.

Burimet e realizuara nga honorarët e auditimeve të njësive ekonomike me interes publik dhe nga kontributet e organizatave të tjera profesionale, subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike mbështesin realizimin e aktiviteteve tona në mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor, të kërkesave të Kodit të Etikës dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Me fokus në cilësinë e auditimit, si kujdestarë të tarifave të mbledhura për të financuar përpjekjet tona, ne duhet të veprojmë në mënyrë sa më efektive dhe efikase të jetë e mundur duke kultivuar më tej një kulturë pune me integritet të lartë, bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse.


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e financimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike:



- ✓ 56% e burimeve nga tarifa 3% nga honorarët NjEIP;
- ✓ 33% e burimeve të ri alokuara nga procesi i provimeve të aftësive profesionale;
- ✓ 11% e burimeve nga tarifa 7% nga organizatat profesionale & të ardhura të tjera;



Përdorimi i burimeve



- 78 %- Paga dhe honorarë
- 11% - Zhvillimi i kapaciteteve dhe Anëtarësime ndërkombëtare
- 9% - Shpenzime Administrative
- 2% - Shpenzime Teknologji Informacioni & Software